

VENDIM
Nr.52, datë 22.7.2010

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE
PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Alfred Lako emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)